

---

---

**PROPERTY RIGHT: SOCIAL OWNERSHIP IN KOSOVO - ON THE LEGAL STATUS OF CONSTRUCTION AND AGRICULTURAL LAND**

**Bajram Seferaj**

Senior Legal Officer, Legal Department– MBPZHR, Republic of Kosovo, [Bajram.Seferaj@rks-gov.net](mailto:Bajram.Seferaj@rks-gov.net) - [seferaj.bami@gmail.com](mailto:seferaj.bami@gmail.com)

**Abstract:** The Constitution of the Republic of Kosovo recognizes and protects the property right on property, as well as the use of property in accordance with the public interest regulated by law. Both the cadaster and the RDPP are established and are in operation in the Republic of Kosovo. Right to Send is a branch of civil law that regulates legal relationships that have objects that are not found in the exchange process. Property is an important institution in human society and has dual economic and legal significance. Ownership as an economic meaning means acquisition of material goods, while ownership in a legal sense means the collection of legal norms that regulate this exploitation. A general view on the right to property and especially the issue of ownership in Kosovo with a special emphasis on the legal status of construction and agricultural land. This paper deals with some of the key issues that are the main factors of the problems in the field of civil law in Kosovo.

**Keywords:** Sendor, Ownership, Constitution of the Republic of Kosovo, Cadaster, Civil.

**E DREJTA E PRONËSISË; PRONËSIA SHOQËRORE NË KOSOVË - MBI STATUSIN JURIDIK TË TOKËS NDËRTIMORE DHE BUJQËSORE**

**Bajram Seferaj**

Senior Legal Officer, Legal Department– MBPZHR, Republic of Kosovo, [Bajram.Seferaj@rks-gov.net](mailto:Bajram.Seferaj@rks-gov.net) - [seferaj.bami@gmail.com](mailto:seferaj.bami@gmail.com)

**Abstrakt:** Kushtetuta e Republikës së Kosovës e njuh dhe e mbron të drejtën e pronësisë mbi pronën, si dhe shfrytëzimin e pronës në pajtueshmëri me interesin publik të rregulluar me ligj. Si kadastru ashtu RDPP-ja janë të themeluara dhe janë në funksion në Republikën e Kosovës. E drejta Sendore është degë e së drejtës civile që i rregullon marrëdhëniet juridike të cilat për objekt të vetin kanë sendet të cilat nuk gjenden në procesin e këmbimit. Prona është një institucion i rëndësishëm në shoqërinë njerëzore dhe ka kuptim të dyfishtë Ekonomik dhe Juridik. Pronësia si kuptim ekonomik do të thotë përvetësim i të mirave materiale, kurse pronësia në kuptim juridik do të thotë grumbullim i normave juridike të cilat e rregullojnë këtë shfrytëzim. Një këndvështrim i përgjithshëm mbi të drejtën sendore e posaqërisht qështjen e pronësisë shoqërisë në Kosovë me një theks të veçantë mbi statusin juridik të tokës ndërtimore e bujqësore. Në këtë punim trajtohen disa nga çështjet kyçe të cilat janë faktorë kryesorë të problemeve në fushën e së drejtës civile në Kosovë.

**Fjalët kyqe:** Sendore, Pronësia, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Katastru, Civile.

**HYRJE**

Fusha e së drejtës civile paraqet një rëndësi në fushat më të rëndësishme në sistemin juridik të një vendi, duke qenë bazë juridike e të gjitha transakcioneve pronësore dhe pasurore. Kosova, historikisht është ballafaquar me një numër të madh të problemeve në këtë fushë. Punimi trajton problemet legjislativë që po ashtu ndërlihen edhe me çështjen e të drejtave të njeriut, duke e ditur se prona konsiderohet e shenjtë nga instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Numri i madh i kontesteve juridiko-civile nëpër gjykatat kosovare është një dëshmi e problemeve serioze në këtë fushë. E drejta e Pronësisë paraqet një rëndësi në institutet juridike më të rëndësishme të drejtës civile, në përgjithësi, respektivisht institutin juridik më të rëndësishëm të drejtës sendore, në veqanti. E drejta e Pronësisë konsiderohet institut themelor juridik-sendor, respektivisht si e drejtë themelore në të drejtën sendore. Pronësia është një institut i lashtë juridik, i cili ka lindur me lindjen edhe të vetë të drejtës. Pronësia është me ndikim në marrëdhëniet e tjera shoqërore. Poashtu si në shumë shtete tjera edhe me Kushtetutë të Republikës së Kosovës garantohet e drejta e Pronësisë. E Drejta Pronësisë është e drejtë themelore e njeriut, e cila është e përfshirë edhe me aktet të ndryshme ndërkombëtare si në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.

## HISTORIKU I TË DREJTËS SENDORE – PRONËSIA

E Drejta Sendore është degë e së drejtës civile që i rregullon marrëdhëniet juridike të cilat për objekt të vetin e kanë sendet të cilat nuk gjenden në procesin e këmbimit. Marrëdhëniet sendore juridike janë marrëdhënie në mes të titullarit të së drejtës sendore dhe të gjithë të tjerëve të cilët eventualisht vijnë në kontakt me sendin. Sipas ligjit i cili rregullon këto institucione janë përcaktuar këto të drejta subjektive sendore si:

- E Drejta e Pronësisë
- E Drejta e Servituteve
- E Drejta e Pengut.

- *Ligjet kryesore mbi Pronësinë:*

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 46 deklaron “E drejta për pronësi është e garantuar.” Neni 113.7 i jep individëve të drejtën për të dërguar peticion tek Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës nëse e drejta e tyre në pronësi sipas nenit 46 është shkelur. ( <http://www.assembly-kosova.org/> )

Ligji për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore (Ligji Nr.2009/03-L-154). Ligj është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2009, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit me Nr.DL-016-2009, dt.15.07.2009.

Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Ligji Nr. 2009/03L-139). Qeveria e Kosovës ka të drejtën për shpronësimin e pronës nëse është e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e një qëllimi publik ose promovimin e interesit publik (neni 4). Ky ligj në nenin 44.1 parasheh që dispozitat e saj duhet të interpretohen dhe zbatohen në përputhje me Konventën Evropiane ( <http://european-convention.eu.int/> ) ashtu si interpretohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

**Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.** Ky ligj Agjencisë i jep fuqi për të privatizuar një aset, në qoftë se ka dëshmi të qarta që një person ka shfaqur interes për ta fituar atë aset si pronësi private. Marrëdhënia juridike tek e drejta sendore ekziston midis personave lidhur me sende të caktuara, sepse është e pamundur që të ekzistojnë marrëdhënie person-send. E drejta e Pronësisë, si degë kryesore sendore, ajo mund të konstituohet vetem mbi sendin ekzistues. Pronësia është e drejtë absolute, që titullarit i jep pushtetin juridik në raport me personat tjerë, ndërsa pushtetin faktik e ushtron mbi sendin, duke e përdorur, shfrytëzuar dhe bartur atë. Në të drejtën Anglo-sanksone nuk haset emërtimi si e drejtë *Sendore*, por në të shumtën e rasteve përmendet *Pronësia apo e drejta e pronësisë*. Shumica e ligjeve në lidhje me të drejtat pronësore dhe të trashëgimisë së grave në Kosovë janë relativisht të reja, që datojnë nga themelimi i shtetit, ku ligji i parë është botuar në vitin 2003.

Para formimit të një shteti të pavarur, të drejtat pronësore dhe trashëgimore të grave janë qeverisur nga ligjet egalitare të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Në tërësi, ligji në Kosovë i plotëson normat ndërkombëtare për barazinë gjinore në sferat ekonomike dhe sociale. Kushtetuta e Kosovës e vitit 2008, në nenin 7 (2) vë në dukje se “Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, duke dhënë mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe fushat e tjera të jetës shoqërore.” Ligji për Pronën dhe të Drejtat Tjera Sendore i miratuar në vitin 2009 përcakton kornizën për të gjitha të drejtat pronësore dhe transferimin e pronës në Kosovë për të gjithë qytetarët. Tre ligjet shitesë sigurojnë një kornizë për barazinë gjinore në Kosovë dhe për qasjen e grave në pronë: Ligji për Barazinë Gjinore, Ligji për trashëgimi, dhe Ligji mbi familjen. Që të tre ligje të gjitha u miratuan në vitin 2004. Pas vitit 1947, fillon procesi i kalimit të pronësisë, nga pronësia shtetërore në pronësi shoqërore. Në vitin 1950 ky proces vazhdon me nxjerrjen e ligjit mbi qeverisjen e ndërmarrjeve ekonomike shoqërore nga ana e kolektivitetit punës, pastaj me ligjin kushtetuese të vitit 1953 dhe se fundi me Kushtetutën e vitit 1963 u formua nocioni i përmbytjes së pronësisë shoqërore. Pas vitit 1970 e deri në vitin 1989, nxirren edhe një varg ligjesh për rregullimin e çështjeve pronësore, një numër i të cilave edhe sot vazhdojnë të jenë të aplikueshme sipas rregullores së UNMIK-ut 1999/24. Pas vitit 1989, kur u bë suprimimi i autonomisë, fillon degradimi i sistemit juridik të Kosovës dhe instalimi i një sistemi tjetër të mbështetur në baza plotësisht diskriminuese. Në këtë drejtim Serbia fillon fazën e ndryshimit respektivisht fillon me nxjerrjen e ligjeve dhe dispozitave tjera diskriminues në kundërshtim të plotë me vullnetin e popullit dhe në kundërshtim me aktet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut. Në problematiken e çështjeve pronësore kanë ndikuar një numër i caktuar rrethanash faktorësh, të cilët në mënyrë të vazhdueshme dhe në faza të caktuara kanë krijuar dhe bartur problemet deri në ditët e sotme. Si forma të shpronësimit pushteti i atëhershëm i ka përdorur: Reformën Agrare, Konfiskimin e pasurisë “armiqve” të popullit, nacionalizimin, shpronësimin etj. Rritjes së problemeve pronësore i ka kontribuar lufta e vitit 1998/99 në Kosovë, u shkatërrua një numër i madh i pronave. E drejta e pronësisë përbëhet kryesisht nga tri autorizime kryesore e të cilat janë:

- Autorizimi i mbajtjes së sendit
- Autorizimi i shfrytëzimit dhe përdorimit të sendit
- Autorizimi i disponimit të sendit. ( *Hetemi, 2006; 180* )

Pronësia ka qenë Institut themelor i të Drejtës Civile dhe ekzistonte në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe mbi skllëverit. Pra ekzistonin disa forma të pronësisë mbi tokën: pronësia shtetërore, pronësia e tempujve, pronësia e bashkësive fshatare e edhe pronësia private. ( *Ismaili; & Sejdiu. 2005; 51* )

Pronësia jo vetëm që trajtohet si e drejtë mbi sendin, por edhe si marrëdhënie juridiko-pronësore. Kemi disa prej shteteve ku pronësia përkufizohet ndryshe si p.sh. Kodi Civil Zviceran parashikon se” kush është pronar i një sendi mund të disponoj me atë send sipas dëshirës së tij, në kufijte e sendit juridik. Legjislacioni Shqiptar pronësinë e përkufizon si “E drejta për të gëzuar dhe disponuar lirish sendet brenda kufijve të caktuar nga ligji”. Republika e Kosovës parasheh Pronësinë me *Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore Nr.03/L-154, ku neni 18 thotë* “Pronësia është e drejta e tërësishme në një send”. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t’i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti. (*Ligji Nr. 03/L-154; 18* )

## HISTORIKU I PRONËS SHOQËRORE

Valët e njëpasnjëshme të eksprijimeve, nacionalizimeve, socializimeve dhe transformimeve që ndodhën gjatë periudhës së Jugosllavisë pas vitit 1945 dukshëm komplikojnë përpjekjet për privatizim në Kosovë. Pas Luftës së Dytë Botërore, autoritetet Jugosllave konfiskuan pronën private të “armiqve” dhe “bashkëpunëtorëve”. Më vonë, qeveria nacionalizoi tokën bujqësore që tejkalonte madhësinë e lejuar me ligj për pronësinë private. Kushtetuta e Republikës Federative të Jugosllavisë (1953) i klasifikoi të gjitha burimet natyrore si pronë shtetërore. Gjatë viteve të 60-tat këshillat e punëtorëve zëvendësuan kontrollin shtetëror dhe prona shoqërore zëvendësoi pronën e nacionalizuar. Kjo arriti kulmin me Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974, e cila përcaktonte se të gjitha mjetet e prodhimit dhe mjetet tjera të punës kolektive, prodhimi i punës kolektive dhe burimet natyrore, si dhe asete të tjera të përcaktuara për përdorim publik ishin prona shoqërore. Prona shoqërore u përcaktua si kategori ligjore në vetë, e ndryshme nga prona private dhe shtetërore. Karakteristika kryesore e pronës shoqërore ishte se bartësit privat të pronave shoqërore nuk fitonin pronësinë, por në fakt të drejtën për shfrytëzim të një aseti të kualifikuar si pronë shoqërore. Ndërmarrjet ishin Ndërmarrje në Pronë Shoqërore (NSh-të) dhe NSh-të shfrytëzonin asetet në pronësi shoqërore. Titullari suprem i pronës shoqërore ishte shoqëria.

Që nga viti 1999, administrata e OKB - UNMIK-u është fokusuar në çështjen e të drejtave pronësore në Kosovë, duke përfshirë edhe ato që ndërlidhen me pronën shoqërore. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë siguron që kompetenca të caktuara të mos përfshihen në ato të Institucioneve të Përkohshme të Kosovës, por të mbesin ekskluzivisht në duart e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (*Rregullorja UNMIK-ut Nr. 2001/9, 2001*). Në mesin e këtyre kompetencave janë *Autoriteti për Administrimin e Pronës Publike*, shtetërore dhe shoqërore; rregullimi i ndërmarrjeve publike dhe shoqërore, si dhe definimi i juridiksionit dhe kompetencës për zgjidhjen e kontesteve ekonomike të pronës. UNMIK-u ka shpallur legjislacione dhe ka krijuar dy institucione - Agjencinë e Mirëbesimit dhe Dhomën e Veçantë - lidhur me administrimin dhe privatizimin e pronës publike, shtetërore dhe shoqërore. Dokument themelor që krijon Agjencinë e Mirëbesimit dhe që përshkruan funksionet e saj është *Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/18*.

Agjencia e Mirëbesimit ka kompetenca për të administruar ndërmarrjet publike dhe N.Sh.-të e regjistruara në Kosovë që nga 31 dhjetori 1988 dhe pronën shoqërore që gjendet në Kosovë që nga 22 marsi 1989. Që nga themelimi i saj, Dhoma e Veçantë ka ndryshuar pikëpamjen e saj për natyrën e Agjencisë të Mirëbesimit dhe autoritetin e tij për të anuluar tenderë. Fillimisht, Dhoma i lejonte Agjencisë të Mirëbesimit zgjedhje të gjerë për të anuluar tenderë. Pastaj, ajo ia kufizojë këtë zgjedhje dhe theksoi që Agjencia e Mirëbesimit duhet të veprojë në mënyrë të drejtë. Sipas Rregullores se UNMIK-ut Nr. 2005/18, Agjencia e Mirëbesimit nuk duhet të përcaktojë statusin e pronësisë së pasurive të NSh-ve para privatizimit. Në vend të kësaj, ajo është e obliguar ta qartësojë këtë çështje pasi të jenë shitur pasuritë, natyrisht duke përfshirë këtu pasi që fillimisht të ketë vendosur se entiteti bie brenda autoritetit të vet, bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/18.3. (*Rreg. UNMIK-ut Nr. 2005/18*)

Nëse Agjencia e Mirëbesimit beson që asetet (e mbetura) e një NSh-je nuk mund të rikthehet në një biznes realizues, ajo inicion likuidimin vullnetar të NSh-së apo çfarëdo pjese të saj. -

- Pezullimi i mundshëm i padive dhe anulimi i transaksioneve,
- Komisionet e Likuidimit,
- Shqyrtimi i vendimeve të Komisioneve të Likuidimit nga Komisioni Shqyrtues dhe Dhoma e Veçantë.

## PRONËSIA SHOQËRORE NË KOSOVË ME THEKS TË VEQANTË MBI STATUSIN JURIDIK TË TOKËS NDËRTIMORE DHE BUJQËSORE

*Paluajtshmëritë*– tokat dhe ndërtesat, në pronësi shoqërore, sipas vëllimit dhe vlerës, përbërjnë pjesën më të madhe të pronësisë shoqërore. Para se gjithash duhet të njihen nocionet e përgjithshme e të veqanta të vet pronësisë

shoqërore si kategori kushtuese. Në Kosovë si dhe në tërë Jugosllavinë, pronësia shoqërore ishte njëherit forma dominuese e pronësisë. Ajo është një lloj e formës së pronësisë kolektive, pronësi sui generis. Përveq pronësisë shoqërore Kushtetuta garantonte edhe pronësinë e kufizuar private, por edhe pronësinë personale. Edhe në kohën kur Kosova ishte pjesë e Federatës Jugosllave si Krahinë Autonome e Federates, pra me Kushtetutën e saj dhe me ligjet e tjera të veqanta, ishte e garantuar pronësia shoqërore me Kushtetutë të KSA-Kosovës (Aliu, 2006. 282) Me ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar në Kosovë dhe administrimin e Kosovës nga UNMIK-u janë krijuar kushtet për krijimin e një legjisllacioni në pajtim me konventat dhe standardet ndërkombëtare, në bazë të të cilave do të funksionoj rendi juridik i Kosovës, ku qytetaret dhe punëtorët që krijuan pronësinë shoqërore në Kosovë do të marrin pjesën në ndarjen e kësaj shoqërie në pajtim me ligjin e ri. Pronësia shoqërore mbi tokën është e rregulluar me kushtetuatat si ato federative ashtu edhe me Kushtetutën e KSA Kosovës, por edhe me një mori ligjesh si: me Kushtetutën e ish-Jugosllavisë të vitit 1946 neni 18 thuhet "toka u takon atyre që e punojnë" ndërsa të gjitha pasuritë minerale në thellësi të tokës, ujërat, janë pasuri mbarë popullore. Poashtu edhe Kushtetuta e Kosovës e vitit 1974 thotë "toka dhe pasuritë tjera natyrore janë të mira me interes të përgjithshëm". Rregjimi juridik mbi tokën ndërtimore është rregulluar me ligjet federative, të RSS dhe KSA-Kosovës: Ligjet federative mbi Qarkullimin e Tokave dhe Ndërtesave. Ligji Themelor mbi Shfrytëzimin e Tokës Bujqësore. Në Kosovë është në fuqi Ligji mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme ( Ligji/G.Z. KSAK)

Me ligjin për tokën ndërtimore të KSA Kosovës dhe ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për tokën ndërtimore në pronësi shoqërore konsiderohet toka e ndërtuar dhe e pandërtuar në qytete dhe në vendbanime me karakter qyteti dhe në lokalitete e parapara për ndërtimin banesor dhe komplekse tjera si vendbanime turistike. Toka nderimore e ndërtuar, respektivisht konsiderohet parcela ndërtimore mbi të cilën janë ndërtuar objektet e dedikuara për përdorim të përhershëm dhe toka që shërben për përdorimin e rregullt të atij objekti. Toka e shpallur si tokë ndërtimore duhet të ndërtohet brenda afatit të caktuar. Ligji mbi token ndërtimore i asaj kohe kur Kosova ishte pjese e Federates Jugosllave kishte parapara disa te drejta mbi tokën ndërtimore në pronësi shoqërore si: të drejten që ta mbajë në posedim tokën e pandërtuar, pronarit të mëparshëm dhe tokën ndërtimore të pandërtuar ta përdor derisa nuk fillon ndërtimi (neni 17 i Ligjit), pastaj të drejten e përparësisë së pronarit të më hershëm për shfrytëzimin e parcelës ndërtimore për ndërtimin e ndërtesës banesore, si dhe të drejtën e Komunës ta jep tokën ndërtimore për shfrytëzim të përkohshëm. Në Kosovë lidhur me tokën ndërtimore në vitin 1972 nxirret Ligji mbi Përcaktimin e Tokës Ndërtimore ( Ligji/G.Z. KSAK). Krahas nxjerrjes së ligjit për tokën ndërtimore, është nxjerrur edhe Ligji për Tokën Bujqësore, ku me këtë fond të tokës bujqësore administron Komuna i cili edhe ben ndarjen e tokës nga fondi në organizatat bujqësore, duke bërë evidentimin e saj, kujdeset për punimin e tokës e cila akoma nuk është ndare organizatave bujqësore ose që u është lënë në shfrytëzim pronarve të mëparshëm. Në vitin 1989 u miratua Ligji për Qarkullimin dhe Disponimin me Kapitalin Shoqëror–Pronësinë Shoqërore. Ndërkaq Kosova nga viti 1989 nuk nxorri ligjet e veta, respektivisht njëanshëm nxorri Kushtetutën me 7 Shtator 1990 por që nuk mundi ta vë në zbatim, sepse në Kosovë u instalua pushteti policor i Serbisë, i cili suprimoi Kuvendin dhe organet tjera shtetërore të Kosovës. Pikërisht nga kjo kohë edhe filloj shkatërrimi i pronësisë shoqërore në Kosovë për shkak të mos administrimit të drejtë të tyre, por edhe për shkak të largimit të punëtorve shqiptarë nga puna. Në Kosovë në vitin 1998-1999 ndodhi edhe lufta dhe intervenimi i forcave ndërkombetare të NATO-s kundër Serbisë ( Jugosllavisë ). Nga 12.06.1999 me Kosovën administrojne Kombet e Bashkuara deri me 17.02.2008 kur edhe u shpall pavarësia. Shtetet që nuk kanë koncept të reprivatizojnë pronësinë mbi tokën, konsiderojnë se toka me automatizëm i takon shtetit. Pra duhet të bëhet patjetër *Denacionalizimi* i pronësisë shoqërore mbi paluajtshmeritë duke përfshirë edhe tokën si atë bujqësore ashtu edhe atë ndërtimore. Në mënyrë të njëjtë duhet të veprohet, si me tokën bujqësore ashtu edhe me atë ndërtimore. Nuk ka arsye për dallim. Republika e Kroacisë dhe Republika e Sllovenisë kanë vënë denacionalizimin e tokës bujqësore dhe tokës ndërtimore, duke krijuar bazë juridike që kjo të bëhet pronësi e pronareve të mëparshëm ose pronarëve të rinj. Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës ka bërë reprivatizimin e pronësisë mbi tokën bujqësore dhe ndërtimore, duke lejuar mundësinë e kthimit pa marrë parasysh se në qfarë baze është marrë toka. Tani Kosova edhe pas përfundimit të luftës si dhe pas shpalljes së pavarësisë më 2008, ka ngecur në nxjerrjen e akteve ligjore dhe nënligjore lidhur me fushën e pronësisë shoqërore.

## KONKLUZIONE

Nga shqyrtimet e mësipërme mund të përfundoj se fusha e së Drejtës Civile në Kosovë ende konsiderohet problematike dhe ka nevojë për përmirësime. Problemet kryesore hasen në fushën e nxjerrjes dhe përmirësimit të legjisllacionit, i cili në shumë raste është diskriminues që nga e kaluara. Nevojë e menjëhershme shtrohet edhe në përmirësimin e efikasitetit të institucioneve gjyqësore në Kosovë, në këtë drejtim rritja e numrit të gjyqtarëve është mjaft me rëndësi dhe shumë jetike për përmirësimin e situatës në këtë fushë. Institucionet kosovare do të duhej të hartonin një strategji të mirëfilltë me qëllim të përmirësimit të situatës. Nxjerrja e një numri të caktuar të ligjeve do

të mund të përmirësonte këtë fushë, edhe pse kjo do të marrë një kohë shumë të gjatë. Gjatë procesit të përmirësimit të legjislacionit dhe politikave institucionet kosovare duhet të krijojnë legjislacion dhe politika në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, si parakusht për një legjislacion dhe politikë të mirëfilltë.

#### REFERENCAT

- Aliu, A. (2006). E Drejta Sendore, Prishtinë
- Hetemi, M. (2006). E drejta Ne Njohurit Themelore Te Se Drejtes Afariste, Prishtine
- Ismaili, H & Sejdiu, F. (2005). Historia e Shtetit dhe se Drejtes, Prishtine
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008), Prishtinë
- Konventa Europjane per te Drejtat e Njeriut – E Drejta e Pronesise.
- Udhëzuesi për hulumtime mbi të drejtën sendore (Ligjin për Pronësinë).
- Ligji Nr. 03/L-154 Për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore
- Ligji Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme
- Ligji Nr. 02/L-26 Për Tokën Bujqësore
- Ligji Nr. 04/L – 110 Për Ndërtim
- Ligji Nr. 04/L-040 Për Rregullimin e Tokës
- Rregullorja e Tokës Bujqësore NR. 2006/37
- <http://www.assembly-kosova.org/>
- [http://www.coe.int/human\\_rights/](http://www.coe.int/human_rights/)